REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court
Adresa: Perandori Justinian, PN. Prishtinë
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

Prishtinë, më 23 qershor 2010
Nr. ref.:AGJ30/10

AKTGJYKIM

Lënda Nr. KI 40/09

IMER IBRAHIMI DHE 48 ISH-PUNËTORË TË TJERË TË KORPORATËS ENERGJETIKE TË KOSOVËS

kundër

49 AKTGJYKIMEVE INDIVIDUALE TË GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare
Iliriana Islami, gjyqtare

Hyrje

Parashtruesit e kërkesës janë:

1. Imer Ibrahimi,
2. Behram Rrahmani,
3. Halit Bilalli,
4. Shefki Veseli,
5. Ramadan Zeqiri,
6. Nazif Grajqevci,
7. Fatime Hyseni,
8. Adem Berisha,
9. Fetah Latifi,
10. Ragip Megjuani,
11. Ali Latifi,
12. Shaban Kodraliu,
13. Sahit Zekolli,
14. Ilaz Ademi,
15. Ali Shala,
16. Shefqet Feta,
17. Selatin Hashani,
18. Jetullah Grajqevci,
19. Avdi Grajqevci,
20. Avdyl Krasniqi,
21. Milazim Shala,
22. Musli Podvorica,
23. Fikrete Hashani,
24. Ferat Berisha,

25. Ahmet Krasniqi,
26. Halit Mjeku,
27. Ali Baruti,
28. Ibush Hashani,
29. Avdyl Luta,
30. Hevzi Demolli,
31. Hajzer Zeqiri,
32. Hilmi Mehmeti,
33. Mustaf Sahiti,
34. Bedri Salihu,
35. Igballe Sallova,
36. Bajram Krasniqi,
37. Murat Rafuna,
38. Fadil Saraqi,
39. Rrahman Merlaku,
40. Zarife Shatrolli,
41. Sami Klinaku,
42. Ismet Grajqevci,
43. Sanije Hashani,
44. Nazmi Raqi,
45. Vehbi Aliu,
46. Selman Berisha,
47. Shefqet Muli,
48. Bajram Syla,
49. Avdullah Selimi

1. Në këtë aktgjykim, për lehtësim referimi, Parashtruesit janë listuar si të numëruar dhe mund të referohen kolektivisht si "Imer Ibrahimi dhe 48 ish-punëtorët e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK)". Në procedurën para Gjykatës Kushtetuese, ata u përfaqësuan nga Këshilli Organizativ i 49 punëtorëve të KEK-ut, rruga Luan Haradinaj, 9-A/1, Prishtinë.

Parashtruesit sfidojnë këto aktgjykime të Gjykatës Supreme të nxjerra në rastet e:

1. Imer Ibrahimi, Rev. nr. 57/2009, i datës 11.02.09;
2. Behram Rrahmani, Rev. nr. 36/2009, i datës 11.02.09;
3. Halit Bilalli, Rev. nr. 136/2008, i datës 11.02.09;
4. Shefki Veseli, Rev. nr. 104/2008, i datës 27.01.09;
5. Ramadan Zeqiri, Rev. nr. 597/08, i datës 10.03.09;
6. Nazif Grajqevci, Rev. nr. 474/08, i datës 10.02.09,
7. Fatime Hyseni, Rev. nr. 534/08, i datës 22.04.09;
8. Adem Berisha, Rev. nr. 48/2009, i datës 11.02.09;
9. Fetah Latifi, Rev. nr. 554/2008, i datës 23.02.09;
10. Ragip Megjuani, Rev. nr. 478/2008, i datës 11.02.09;
11. Ali Latifi, Rev. nr. 521/2008, i datës 23.02.09;
12. Shaban Kodraliu, Rev. nr. 544/2008, i datës 11.02.09;
13. Sahit Zekolli, Rev. nr. 90/2008, i datës 25.02.09;
14. Ilaz Ademi, Rev. nr. 229/2008, i datës 10.02.09;
15. Ali Shala, Rev. nr. 54/2009, i datës 11.02.09;
16. Shefqet Feta, Rev. nr. 487/2008, i datës 11.02.09;
17. Selatin Hashani, Rev. nr. 59/09, i datës 30.06.08;
18. Jetullah Grajqevci, Rev. nr. 150/2009, i datës 02.06.09;
19. Avdi Grajqevci, Rev. nr. 227/2008, i datës 11.02.09;
20. Avdyl Krasniqi, Rev. nr. 476/2008, i datës 23.02.09;
21. Milazim Shala, Rev. nr. 574/2008, i datës 11.02.09;
22. Musli Podvorica, Rev. nr. 464/2008, i datës 23.02.09;
23. Fikrete Hashani, Rev. nr. 225/2009, i datës 18.06.09;
24. Ferat Berisha, Rev. nr. 138/2009, i datës 02.06.09;
25. Ahmet Krasniqi, Rev. nr. 426/2008, i datës 10.02.09;
26. Halit Mjeku, Rev. nr. 567/08, i datës 10.03.09;
27. Ali Baruti, Rev. nr. 45/2009, i datës 11.02.09;
28. Ibush Hashani, Rev. nr. 97/2009, i datës 17.03.09;
29. Avdyl Luta, Rev. nr. 565/2008, i datës 11.02.09;
30. Hevzi Demolli, Rev. nr. 64/2009, i datës 02.02.09;
31. Hajzer Zeqiri Rev. nr. 518/2008, i datës 23.02.09;
32. Hilmi Mehmeti, Rev. nr. 571/2008, i datës 11.02.09;
33. Mustaf Sahiti, Rev. nr. 259/2008, i datës 23.02.09;
34. Bedri Salihu, Rev. nr. 435/2008, i datës 10.02.09;
35. Igballe Sallova, Rev. nr. 545/2008, i datës 23.02.09;
36. Bajram Krasniqi, Rev. nr. 569/2008, i datës 23.02.09;

37. Murat Rafuna, Rev. nr. 491/2008, i datës 23.02.09;
38. Fadil Saraqi, Rev. nr. 506/2008, i datës 23.02.09;
39. Rrahman Merlaku, Rev. nr. 441/2008, i datës .10.02.09;
40. Zarife Shatrolli, Rev. nr. 454/2008, i datës 23.02.09;
41. Sami Klinaku, Rev. nr. 63/2009, i datës 11.02.09;
42. Ismet Grajqevci, Rev. nr. 479/2008, i datës 23.02.09;
43. Sanije Hashani, Rev. nr. 460/2008, i datës 11.02.09;
44. Nazmi Raqi, Rev. nr. 270/2009, i datës 18.06.09;
45. Vehbi Aliu, Rev. nr. 269/2009, i datës 01.07.09;
46. Selman Berisha, Rev. nr. 41/09, i datës 30.06.09;
47. Shefqet Muli, Rev. nr. 222/2008, i datës 10.02.09;
48. Bajram Syla, Rev. nr. 142/2009, i datës 17.03.09 dhe
49. Avdullah Selimi, Rev. nr. 438/2008, i datës 10.02.09

Objekti i çështjes

2. Çështja e lëndës së kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve individuale të nxjerra nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës në 49 raste individuale të Parashtruesve kundër KEK-ut, të cekur më lartë.

Baza ligjore

3. Kërkesa bazohet në Nenin 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta); Nenin 20 të Ligjit nr. 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (më tej: Ligji), dhe Nenin 54(b) të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (më tej: Rregullorja e punës).

Përmbledhje e fakteve që pretendohet nga palët

4. Që në fillim duhet të theksohet se Kërkesat e Parashtruesve cekin çështje identike që burojnë nga i njëjti problem themelor që parashtrohet në paragrafët 4 – 28 në vijim.
5. Gjatë vitit 2001 dhe 2002, secili parashtrues nënshkroi një marrëveshje për kompensim të përkohshëm të pagesës për shkëputje të kontratës së punës me punëdhënësin e tyre, KEK-un. Këto marrëveshje ishin, në thelb, të njëjta.

6. Neni 1 i kësaj Marrëveshjeje përcakton se, në mbështetje të Nenit 18 të Ligjit mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Kosovës (Gazeta Zyrtare e ish Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës nr. 26/83, 26/86 dhe 11/88) dhe konstatimit të Komisionit Invalidor të KEK-ut, përfituesi (d.m.th. secili parashtrues) ka të drejtë për kompensim të përkohshëm për ndërprerje të marrëdhënies së punës, deri në themelimin dhe funksionimin e Fondit mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Kosovës.

7. Neni 2 i kësaj Marrëveshjeje përcaktoi se shuma mujore që duhet t'i paguhet secilit parashtrues ishte 206 marka gjermane.

8. Neni 3 përcaktoi se "pagesa sipas kësaj Marrëveshjeje fillon prej datës 19.07.2001 dhe përfundon në ditën e funksionimit të Fondit mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Kosovës. Prej asaj dite e tutje, shfrytëzuesi mund t'i realizojë të drejtat e veta në Fondin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Kosovës, gjersa KEK-ut i ndërpriten obligimet ndaj shfrytëzuesit nga kjo Marrëveshje".

9. Më 1 nëntor 2002, Bordi Ekzekutiv i KEK-ut miratoi një vendim për themelimin e fondit pensional, në përputhje me kriteret e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/30 mbi Pensionet në Kosovë. Neni 3 i këtij vendimi thotë: "Fondi Pensional do të vazhdojë të ekzistojë për një periudhë të pacaktuar kohore, në pajtim me kriteret dhe përgjegjësitë e përcaktuara me rregulloret mbi pensionet, të miratuara nga Bordi i Fondit Pensional dhe KEK-u, në përputhje me këtë vendim, apo derisa kushtet ligjore për ekzistimin dhe funksionimin e Fondit të jenë në përputhje me rregulloret mbi pensionet ose rregullat mbi pensionin të miratuara nga ABPK-ja."

10. Më 25 korrik 2006, Bordi Ekzekutiv i KEK-ut e anuloi vendimin në fjalë mbi themelimin e Fondit Pensional Suplementar dhe ndërpreu financimin dhe punën e Fondit Pensional Suplementar, me efekt që nga 31 korriku 2006. Sipas vendimit të 25 korrikut 2006, të gjithë përfituesve u garantohej pagesa e plotë në përputhje me Statutin e Fondit. Për më tepër, obligimi i përgjithshëm ndaj përfituesve ishte 2, 395,487 euro, depozitat bankare ishin 3,677,383 euro dhe suficiti nga përgjegjësia ishte 1,281,896 euro. Vendimi thotë se punëtorët e KEK-ut të cilët Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i pranon si persona me aftësi të kufizuar për punë do të gëzojnë të drejtat e parapara nga Ministria. Më 14 nëntor 2006, KEK-u e informoi Autoritetin Qendror Bankar se "vendimi për revokimin e Fondit Pensional të KEK-ut bazohet në vendimin e Bordit Ekzekutiv të KEK-ut dhe në vendimin e Bordit Menaxhues për Pensione ... <u>për shkak të rrezikut financiar që kjo skemë paraqet për KEK-un në të ardhmen</u>."

11. Sipas Parashtruesve, KEK ndërpreu pagesën e paraparë me marrëveshjet e verës 2006 pa asnjë njoftim. Parashtruesit pohojnë që një veprim i tillë është në kundërshtim me marrëveshjet e nënshkruara.

12. Parashtruesit gjithashtu pohojnë që dihet mirë se Fondi Pensional dhe Invalidor i Kosovës nuk është themeluar ende.

13. Në anën tjetër, KEK-u i konteston pohimet e parashtruesve duke thënë se Fondi Pensional dhe Invalidor funksionon që nga 1 janari 2004.

14. Sipas KEK-ut, parashtruesit në mënyrë automatike mbulohen nga skema kombëtare invalidore në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/40 për Shpalljen e Ligjit mbi Pensionet Invalidore në Kosovë (Ligji nr. 2003/23).

15. KEK-u më tutje thotë që më 31 gusht 2006 lëshoi një njoftim sipas të cilit të gjithë përfituesit e Fondit Suplementar të KEK-ut ishin njoftuar se Fondi ishte mbyllur. I njëjti njoftim konfirmonte se të gjithë përfituesve u garantohej pagesa e plotë në përputhje me Statutin e FPS-së, që do të thotë 60 muaj pagese ose derisa përfituesit ta arrijnë moshën 65-vjeçare, në përputhje me Vendimin e Bordit Drejtues (Menaxhues) të Fondit Pensional të 29 gushtit 2006.

16. KEK-u më tutje thotë që parashtruesit nuk i kanë kontestuar udhëzimet për pension invalidor dhe nënshkrimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës në përputhje me konkluzionet e Komisionit Invalidor.

17. Parashtruesit ngritën padi kundër KEK-ut në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Ata kërkuan që Gjykata të urdhëronte KEK-un t'ua paguante pagesat e papaguara dhe të vazhdonte t'ua paguante nga 105 euro (që është e barabartë me 206 marka gjermane) deri në përmbushjen e kushteve për ndërprerjen e pagesës.

18. Gjykata Komunale në Prishtinë miratoi paditë e parashtruesve dhe urdhëroi kompensim monetar. Gjykata Komunale në Prishtinë gjeti (p.sh. Aktgjykimi C Nr.

1891/2006 i 15.1.2008, në rastin e Parashtruesit të parë Imer Ibrahimi) se kushtet e parapara në Nenin 3 të Marrëveshjes nuk janë përmbushur. Neni 3 i Marrëveshjes parashikon kompensimin e pagës deri në realizimin e të drejtës së parashtruesve, "që do të thotë të drejtën për pension, që nuk është e mundur për paditësin sepse ai nuk e ka arritur moshën 65 vjeçare."

19. Gjykata Komunale më tej theksoi në Aktgjykimin e sipërpërmendur se pagesa e kompensimit nuk duhet të lidhet me dispozitat e Statutit Suplementar Pensional, pasi marrëveshjet ishin nënshkruar më herët dhe Statuti nuk ka paraparë se marrëveshjet e lidhura në rastet e mëhershme do të pushojnë së qeni të vlefshme. Gjykata gjithashtu sqaroi se sipas nenit 262 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore, kreditori (d.m.th. një parashtrues) kishte të drejtë të kërkonte përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori (d.m.th. KEK-u) është i detyruar ta përmbushë detyrimin e tillë.

20. KEK-u paraqiti ankesë ndaj aktgjykimeve të Gjykatës Komunale në Gjykatën e Qarkut, duke thënë, ndër të tjera, se aktgjykimi i Gjykatës Komunale nuk ishte i drejtë sepse marrëveshjet ishin nënshkruar me parashtrues për shkak të invaliditetit të tyre dhe se nuk mund të kërkojnë vazhdimin e marrëdhënies së punës për shkak të invaliditetit të tyre.

21. KEK-u ritheksoi se Gjykata ishe e detyruar të vendoste duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/40 për Shpalljen e Ligjit mbi Pensionet Invalidore sipas të cilës parashtruesit kishin të drejtë për pension invalidor.

22. Gjykata e Qarkut në Prishtinë hodhi poshtë ankesat e KEK-ut dhe i gjeti parashtresat e tyre të pabaza (p.sh. aktgjykimi i 22 tetorit 2008, Ac. Nr. 719/2008, në rastin e Parashtruesit të parë Imer Ibrahimi). Sipas Gjykatës, ndërprerja e Marrëveshjeve dhe ndërprerja e kompensimit të pagës ishte në kundërshtim me Nenin 3 të marrëveshjes, posaçërisht duke pasur parasysh që nëse punëtori ka qenë i njoftuar për një masë të tillë, ai nuk do ta kishte nënshkruar marrëveshjen dhe do të kishte vazhduar të punonte për të padituri (KEK-un).

23. KEK-u ka parashtruar revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljeve thelbësore të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe zbatimit të gabuar të ligjit material (p.sh. Revizioni nga KEK-u më 17 nëntor në rastin e parashtruesit të parë Imer Ibrahimi). Aty përsëritej që Parashtruesit kishin të drejtë pensioni sipas Ligjit 2003/40 dhe për shkak të arsyeve humanitare KEK-u kishte vazhduar të paguante kompensimet mujore edhe pas hyrjes së Ligjit në fuqi. Argumentohej që mosha e aplikuesit nuk ishte me rëndësi, por invaliditeti.

24. Gjykata Supreme miratoi revizionet e KEK-ut, rrëzoi aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës Komunale në Prishtin dhe refuzoi si të pabazuara kërkesë-paditë e Parashtruesve.

25. Gjykata Supreme ka theksuar që mënyra e ndërprerjes së punësimit konsiderohet e ligjshme sipas Nenit 11.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27 mbi Ligjin Bazë të Punës në Kosovë.

26. Gjykata Supreme gjithashtu theksoi, në rastin e Imer Ibrahimit (shih Aktgjykimin e Gjykatës Rev. Nr.57/2009 të 11 shkurtit 2009), si në vijim: "duke marrë parasysh faktin e pakontestueshëm që pala e paditur ka përmbushur obligimin ndaj paditësit, që është pagesa e kompensimit të pagave sipas periudhës së specifikuar, që është deri në themelimin dhe funksionimin e Fondit të Sigurimit Invalidor dhe Pensional, me hyrje në fuqi prej 1 janarit 2004, Gjykata ka vendosur që pala e paditur ka kryer obligimin sipas marrëveshjes. Kështu, pohimet e paditësit që pala e paditur ka për

obligim të paguajë kompensimin e përkohshëm të pagave pas themelimit të Fondit të Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore konsiderohen nga kjo Gjykatë si të pabaza, për shkak se palët kontraktuese, deri në daljen e kushtit zgjidhës – themelimin e fondit të lartpërmendur, kanë kryer obligimet e tyre kontraktuale. "

27. Më 15 maj 2009, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Kosovës lëshoi këtë njoftim për Parashtruesit: "Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, në arsyetimin e Aktgjykimit Rev. I Nr 454/2008, që në Republikën e Kosovës ekziston Fondi i Sigurimit Invalidor dhe Pensional që është funksional qysh prej 1 janarit 2004 nuk është i saktë dhe i pabazuar. Në dhënien e kësaj deklarate, ne konsiderojmë se fakti që Rregullorja e UNMIK-ut 2003/40 për shpalljen e Ligjit Nr. 2003/213 mbi Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, i cili rregullon rastet e personave me paaftësi të përhershme, të cilët mund të gëzojnë këtë skemë në pajtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë ligj. Më lejoni të theksoj megjithatë që dispozitat e këtij Ligji nuk rregullojnë themelimin e Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore të vendit. Themelimi i Fondit të Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore në Republikën e Kosovës përcaktohet me Ligjin mbi Pensionet Invalidore i cili është në proces të hartimit dhe miratimit në Qeverinë e Kosovës." I njëjti shënim thekson që në kohën e shkrimit të atij shënimi, pensioni *inter alia* ekzistonte "pension invalidor në shumën e 45 Eurove, siç rregullohet me Ligjin për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar (përfitues të këtij janë gjithë personat me aftësi të kufizuara të përhershme dhe të plotë)", si dhe "pensionet e kontribut-dhënësve prej 82 Eurosh, të cilat rregullohen me Vendim të Qeverisë (përfitues të të cilit janë gjithë pensionistët që kanë arritur moshën e pensionimit prej 65 vitesh, si dhe të cilët kanë 15 vjet përvojë pune)".

28. Gjykata Kushtetuese është njoftuar që disa nga Parashtruesit, duke përfshirë të parin, Imer Ibrahimi, kanë parashtruar propozime për rigjykim të lëndës në Gjykatën Komunale në Prishtinë, në bazë të shënimit të lartpërmendur të Ministrisë më 15 maj 2009. KEK-u ka kundërshtuar. Megjithatë, në rastin e Z. Ibrahimi, si dhe në 11 raste tjera, pra 12 Parashtruesit e parë në listë, Gjykata e Qarkut ka lejuar rigjykimin në procedurë kontestimore dhe ka prishur aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës. Gjykata e Qarkut ka bazuar këto vendime në Nenin 239 paragrafi 1, të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Rastet e këtyre parashtruesve aktualisht presin zgjidhjen në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

29. Disa Parashtrues, sidomos parashtruesit me numrin 13, 14, 15, 16 dhe 17, janë më të moshuar se 65 vjet.

Ankimet

30. Parashtruesit ankohen që të drejtat e tyre janë shkelur për shkak se KEK-u në mënyrë të njëanshme ka anuluar Marrëveshjet e tyre, përkundër faktit se kushti i përcaktuar me Nenin 3, themelimi i Fondit të Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore, nuk është përmbushur. Parashtruesit theksojnë më tutje se nuk kanë pasur mundësi të kundërshtojnë një shkelje të tillë në gjykatat e rregullta. Derisa Parashtruesit shprehimisht nuk ankohen për shkeljen e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), duket nga parashtresat e Parashtruesve se lënda e ankesave të tyre është e drejta pronësore (siç garantohet me Nenin 1, Protokollin 1, KEDNJ), si dhe e drejta për gjykim të drejtë (garantuar me Nenin 6 të KEDNJ-së).

Përmbledhje e procedurave para Gjykatës

31. Më 11 shtator 2009, Parashtruesit kanë dorëzuar Kërkesën e tyre në Gjykatën Kushtetuese. Kryetari emëroi Gjyqtar Kadri Kryeziun si Gjyqtar Raportues dhe

emëroi Kolegjin Shqyrtues të Gjykatës, me Gjyqtar Altay Suroy, Kryetar i Kolegjit, Enver Hasani dhe Iliriana Islami, anëtarë. Më 23 nëntor 2009, Gjykata Kushtetuese njoftoi Gjykatën Supreme, në pajtim me Nenin 26 të Ligjit, se Parashtruesit kanë sfiduar 49 aktgjykime individuale të lëshuara nga Gjykata Supreme.

32. Më 4 dhjetor 2009, Gjykata kërkoi informata shtesë për Kërkesën nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe KEK-u. Më 20 janar 2010, Gjykata Kushtetuese i kërkoi edhe Gjykatës Komunale në Prishtinë, në pajtim me Nenin 26 të Ligjit, që të ofrojë një kopje të të gjitha shkresave të rastit të Parashtruesit të parë.

33. Më 19 shkurt 2010, Kolegji Shqyrtues u mblodh për të shqyrtuar Raportin e Gjyqtarit Raportues. Më 30 prill 2010, u mbajt dëgjimi publik, ku 49 punëtorët e KEK-ut u përfaqësuan nga Këshilli Organizativ. Përfaqësuesit e KEK-ut dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ishin të pranishëm, bashkë me palët e interesuara. Më 14 dhe 19 maj 2010, si dhe më 16 qershor 2010, Gjykata u mblodh në seanca të mbyllura për të shqyrtuar rastin.

Pranueshmëria

34. Në mënyrë që të trajtohen Kërkesat e Parashtruesve, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesit kanë përmbushur kriteret e përcaktuara me Kushtetutë.

35. Në lidhje me këtë Gjykata i referohet Nenit 113.7 të Kushtetutës që përcakton se:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj;"

dhe Neni 47.2 i Ligjit përcakton që:

"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

36. Siç është theksuar më lart, Gjykata Kushtetuese ka marrë kopjet e 12 vendimeve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, në lidhje me 12 Parashtruesit e parë, për të cilët është miratuar kërkesa për rigjykim në procedurë kontestimore nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë. Si pasojë, Gjykata e Qarkut ka prishur aktgjykimet në vijim të Gjykatës Supreme të Kosovës në rastet e parashtruesve më poshtë:

1. Imer Ibrahimi, Rev. 57/2009 i datës 11.02.09, rrëzuar me Vendimin Ac.nr.732/09 të datës 12.11.09;
2. Behram Rrahmani Rev.36/2009, datë 11.02.09, rrëzuar me Vendimin Ac.nr.760/09 të datës 12.11.09
3. Halit Bilalli, Rev. 136/2008, datë 11.02.09, rrëzuar me Vendimin Ac.nr. 735/09 me datë 01.12.09;
4. Shefki Veseli, Rev. 104/2008, datë 27.01.09, rrëzuar me Vendimin Ac.nr. 700/09 datë 01.12.09;
5. Ramadan Zeqiri, Rev. 597/08 datë 10.03.09, rrëzuar me Vendimin Ac.nr. 841/09 të datës 02.12.09;
6. Nazif Grajqevci, Rev. 474/08 datë 10.02.09, rrëzuar me Vendimin Ac.nr.728/09 të datës 01.12.09;
7. Fatime Hyseni, Rev. 534/08 datë 22.04.09, rrëzuar me Vendimin Ac.nr. 839/09 të datës 01.12.09;

8. Adem Berisha, Rev. 48/2009 datë 11.02.09, rrëzuar me Vendimin Ac.nr.734/09 of 26.08.09;
9.Fetah Latifi, Rev. 554/2008 datë 23.02.09, rrëzuar me Vendimin Ac.nr.761/09 të datës 01.12.09;
10. Ragip Megjuani Rev 478/2008 datë 11.02.09, rrëzuar me Vendimin Ac.nr.757/09 të datës 26.08.09;
11. Ali Latifi, Rev. 521/2008 datë 23.02.09 rrëzuar me Vendimin Ac. nr.730/09 të datës 26.08.09;
12. Shaban Kodraliu Rev 544/2008 datë 11.02.09 rrëzuar me Vendimin Ac. nr.705/09 të datës 1.12.09

37. Sipas informatave që Gjykata Kushtetuese ka marrë, rastet e 12 Parashtruesve si më lart janë në pritje në Gjykatë. Kështu, Gjykata Kushtetuese konsideron që ankesat e tyre janë të parakohshme.

38. Gjykata më tutje duhet të marrë parasysh nëse Parashtruesit kanë dorëzuar Kërkesat e tyre brenda afatit katër-mujor të përcaktuar me Nenin 49 të Ligjit. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese i referohet Nenit 49 të Ligji, i cili parashikon që:

"Kërkesa duhet të dorëzohet brenda një periudhe prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet prej ditës së pranimit të vendimit gjyqësor nga parashtruesi. Në gjitha rastet tjera, afati do të llogaritet prej ditës kur vendimi apo akti shpallet publikisht...".

39. Gjykata përkujton se ekziston një kriter i ngjashëm i pranueshmërisë i përcaktuar me Nenin 35, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, "qëllimi i rregullit [gjashtë-mujor] është që të promovojë sigurinë e ligjit, që të sigurojë që rastet që kanë të bëjnë me çështje të Konventës të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme, si dhe që të mbrojë autoritetet dhe personat tjerë të përfshirë nga paqartësia për një periudhë të gjatë kohore (shih mes shumë rasteve tjera, rasti i P.M. kundër Mbretërisë së Bashkuar (dec), nr 6638/03, vendimi i 24 gushtit 2004). Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut më tutje përcakton që "ky rregull gjithashtu i jep parashtruesit të ardhshëm kohë për të shqyrtuar nëse dëshiron të parashtrojë kërkesën, si dhe nëse po, të vendosë për ankesat dhe argumentet që dëshiron të paraqesë (rasti O'Loughlin dhe tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar (dec), nr 23274/04, aktvendimi i 25 gushtit 2005), si dhe mundëson vërtetimin e fakteve në një rast, të cilat me kalimin e kohës e bëjnë problematik shqyrtimin e drejtë të çështjeve të ngritura (rasti Nee kundër Irlandës (dec.), nr 52787/99, vendimi i 30 janarit 2003)".

40. Megjithatë, afati kohor i përcaktuar me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk fillon të llogaritet nëse ankesa për Konventën del nga një situatë në vazhdim e sipër. Shembujt e situatave të vazhdueshme përfshijnë ankesat që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e procedurave të gjykatave vendore, paraburgimit dhe pamundësisë së gëzimit të posedimeve. Sipas praktikës gjyqësore, aty ku pohohet shkelja në një situatë të vazhdueshme, afati kohor fillon të llogaritet vetëm nga përfundimi i situatës së vazhdueshme (shih rastin Jèčius kundër Lituanisë, Parashtresa nr. 34578/9 7, Aktgjykimi i GJEDNJ më 31 korrik 2000, para 44).

41. Në rastin aktual, Parashtruesit ende vuajnë nga anulimi i njëanshëm i Marrëveshjeve të tyre të nënshkruara nga KEK-u. Ata pohojnë që është mirë e ditur që Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor nuk është themeluar ende. Kështu, kjo është situatë e vazhdueshme. Pasi rrethanat për të cilat Parashtruesit ankohen janë në vazhdim e sipër, periudha katër-mujore e përcaktuar me nenin 49 të Ligjit nuk vlen në këto raste.

42. Gjykata Kushtetuese është e vetëdijshme që disa Parashtrues kanë qenë më të moshuar se 65 vjet në kohën e dorëzimit të Kërkesës së tyre në Gjykatë.

43. Këta Parashtrues janë
13. Sahit Zekolli, lindur me 1943;
14. Ilaz Ademi, lindur me 1945;
15. Ali Shala, lindur me 1945;
16. Shefqet Feta, lindur me 1945;
17. Selatin Hashani, lindur me 1944.

44. Gjykata Kushtetuese përkujton se Parashtruesit i kanë bashkëngjitur Kërkesës së tyre Shënimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të 15 majit 2009 (shih paragrafin 27 më lart), sipas të cilit personat që kanë arritur moshën e pensionimit prej 65 vitesh, si dhe që kanë së paku 15 vjet përvojë pune kanë të drejtë pensioni prej një shume mujore prej 82 Eurosh. Esenca e këtij Shënimi është konfirmuar nga përfaqësuesi i Ministrisë në seancën publike të Gjykatës mbajtur me 30 prill 2010.

45. Rrjedhimisht, duket që Parashtruesit si më lart kanë të drejtë pension qysh prej momentit të mbushjes së moshës prej 65 vitesh.

46. Megjithatë, ankesat e tyre, deri në masën e kompensimit të papaguar për periudhën deri në atë moment, në kuptimin e situatës së vazhdueshme, mbeten tw tilla.

47. Kështu, Kërkesat e Parashtruesve 13. Sahit Zekolli, 14.Ilaz Ademi, 15. Ali Shala, 16.Shefqet Feta dhe 17. Selatin Hashani janë pjesërisht të pranueshme.

48. Duke marrë parasysh Parashtruesit prej 18-49, Gjykata Kushtetuese nuk sheh arsye për papranueshmërinë e Kërkesës.

Meritumi

i. Sa i përket mbrojtjes së pronësisë

49. Parashtruesit ankohen se të drejtat e tyre janë shkelur për shkak se KEK-u ka anuluar Marrëveshjet e tyre në mënyrë të njëanshme, edhe pse kushti i përcaktuar me nenin 3 (pra themelimi i Fondit të Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore) nuk është përmbushur. Në thelb, Parashtruesit ankohen që ka pasur shkelje të të drejtave të tyre pronësore.

50. Qysh në fillim, duhen rikujtuar dispozitat juridike si në vijim:

Neni 53 i Kushtetutës,

> *"Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë do të interpretohen në përputhje me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."*

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës parasheh si në vijim

> *1. E drejta e pronësisë është e garantuar.*
> *2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj në pajtim me interesin publik.*
> *3. Askush nuk mund të privohet nga prona në mënyrë arbitrare. Republika e Kosovës apo autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të shpronësojë pronën nëse shpronësimi i tillë është i autorizuar me ligj, është i*

domosdoshëm apo i përshtatshëm për arritjen e një qëllimi publik apo promovimin e interesit publik, si dhe përcillet me ofrimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat të personit apo personave, prona e të cilëve është shpronësuar.

Neni 1 i Protokollit Nr. 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, parasheh

"Secili person fizik apo juridik ka të drejtë të gëzojë posedimet e tij në mënyrë të qetë. Askush nuk mund të privohet nga posedimet e tij/saj përveç për interes publik si dhe duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara me ligj, si dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat paravajtëse nuk do të pengojnë në asnjë mënyrë të drejtën e Shtetit që të zbatojë ligje që i konsideron të domosdoshme për kontrollimin e shfrytëzimit të pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm, apo për të siguruar pagesën e tatimeve apo kontributeve e dënimeve tjera."

51. Gjykata Kushtetuese rithekson jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sipas të cilës koncepti i "posedimeve" i përmendur në pjesën e parë të Nenit 1 të Protokollit nr. 1 ka një kuptim autonom, i cili nuk kufizohet në pronësinë e të mirave fizike, si dhe është i pavarur nga klasifikimi formal në ligjin vendor: disa të drejta dhe interesa tjera që përbëjnë asete munden gjithashtu të shihen si "të drejta pronësore" dhe kështu si "posedime" për qëllimin e Nenit 1, Protokollit nr. 1.

52. Në fakt, kjo dispozitë nuk garanton të drejtën e fitimit të pronës (shih *mutatis mutandis* Kopecký kundër Sllovakisë, Parashtresa nr. 44912/98, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, 28 shtator 2004). Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Parashtruesi mund të pohojë shkeljen e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 vetëm deri në masën që vendimet e goditura kanë të bëjnë me "posedimet" e tij brenda kuptimit të kësaj dispozite.

53. Për më shumë, "posedimet" mund të jenë ose "posedime ekzistuese" apo asete, duke përfshirë pohimet, në kuptimin e të cilave parashtruesi mund të argumentojë që ai apo ajo ka "pritje legjitime" të fitimit dhe të gëzimit efektiv të një të drejte pronësore. Në kundërshtim me këtë, shpresa e njohjes së një të drejte pronësore e cila ka qenë e pamundur të ushtrohet në mënyrë efektive nuk mund të konsiderohet "posedim" sipas kuptimit të nenit 1 të Protokollit Nr. 1, ashtu siç nuk mund të konsiderohet posedim as kërkesa me kusht, i cili zgjidhet si rezultat i mos-përmbushjes së kushtit (shih Kopecký, cituar më lart, paragraf 35; Prince Hans-Adam II i Lihtenshtajnit kundër Gjermanisë, nr. 42527/98, paragrafët 82-83, GJEDNJ 2001-VIII; dhe Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (dec.) [GC], nr. 39794/98, para. 69, GJEDNJ 2002-VII).

54. Çështja që duhet shqyrtuar në çdo rast është nëse rrethanat e rastit, të marra në përgjithësi, i japin Parashtruesit pronësi ndaj një interesi thelbësor të mbrojtur nga neni 1, Protokolli 1, i KEDNJ-së (shih Iatridis kundër Greqisë, [GC], nr. 31107/96; Beyeler kundër Italisë [GC], nr. 33202/96, § 100, GJEDNJ 2000-I; Broniowski kundër Portugalisë [GC], nr. 31443/96, para. 129, GJEDNJ 2004-V; dhe Anheuser-Busch Inc. Kundër Portugalisë [GC], nr. 73049/01, para. 63. GJEDNJ 2007-...).

55. Gjykata Kushtetuese vëren se në kohën e përmbylljes së Marrëveshjeve mes Parashtruesve dhe KEK-ut, ky lloj i marrëveshjeve është rregulluar me Ligjin mbi

Marrëdhëniet Detyrimore (Ligji për obligimet), botuar në Gazetën Zyrtare SFRJ 29/1978 dhe ndryshuar më 39/1985, 45/1989, 57/1989.

Neni 74(3) i Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore thekson si në vijim:

"Pas shkëputjes me kushtin zgjidhës, kontrata pushon të jetë e vlefshme pasi ai kusht të jetë i vlefshëm."

56. Thelbi i çështjes kështu është nëse kushti zgjidhës sipas të cilit janë nënshkruar Marrëveshjet është përmbushur. Përgjigja ndaj kësaj pyetjeje do t'i mundësonte Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë nëse rrethanat e kësaj Kërkese, të shqyrtuar si të tërë, i japin Parashtruesve të drejtën ndaj interesit thelbësor të mbrojtur nga Neni 1, Protokolli nr. 1 i KEDNJ-së.

57. Gjykata Kushtetuese vëren se është e qartë nga dokumentet dhe është e pakontestueshme mes palëve që "kushti zgjidhës" sipas të cilit janë nënshkruar Marrëveshjet është themelimi dhe funksionimi i Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Kosovës.

58. Në këtë kuptim, Gjykata Kushtetuese gjithashtu vëren që sipas Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, themelimi i Fondit të Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore, deri në datën e dëgjimit, do të duhej rregulluar me Ligjin mbi fondet e sigurimeve pensionale dhe invalidore. Ky i fundit ka qenë në proces të hartimit dhe miratimit në Qeverinë e Kosovës. Përfaqësuesi i Ministrisë ka konfirmuar këtë informatë në dëgjimin publik në Gjykatën Kushtetuese të mbajtur më 30 prill 2010.

59. Gjykata më tutje vëren që Neni 1 i Marrëveshjeve i referohen Nenit 18 të Ligjit mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor (Gazeta Zyrtare e ish Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Nr. 26/83, 26/86 dhe 11/88). Neni 18 i Ligjit mbi Sigurimet Pensionale dhe Invalidore të vitit 1983, përcakton si në vijim:

> *"Personi i siguruar ka të drejtë të pensionimit të hershëm pas mbushjes së moshës 55 dhe 35 vitesh përvojë (meshkujt), apo respektivisht mosha 50 dhe 35 vite përvojë pune (gratë).*
>
> *Pensionimi i hershëm do të përcaktohet sipas gjatësisë së përvojës së punës dhe do të zvogëlohet për 0.5% çdo vit të pensionimit të hershëm deri në arritjen e moshës 60-vjeçare (meshkujt), respektivisht 55 vjeçare (gratë).*
>
> *Kur përfituesi i pensionit të hershëm arrin moshën prej 60 vitesh (meshkujt), respektivisht 55 vitesh (gratë), pensioni nuk do të zvogëlohet sipas paragrafit 2 të këtij Neni."*

60. Gjykata Kushtetuese konsideron se Parashtruesit, me nënshkrimin e Marrëveshjeve të tyre me KEK-un, kanë pasur pritje legjitime që do të gëzojnë dëmshpërblimin mujor në shumën prej 105 Eurosh, deri në themelimin e Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor.

61. Pritja e tillë legjitime garantohet me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës, natyra e saj është konkrete, dhe jo vetëm shpresë e thjeshtë, si dhe bazohet në një dispozitë ligjore apo akt ligjor, pra Marrëveshjen me KEK-un (shih *mutatis mutandis* Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (dec.), nr. 39794/98, para 73, GJEDNJ 2002-VII).

62. Kështu, Gjykata Kushtetuese konsideron se Parashtruesit kanë "pritje legjitime" që kërkesa e tyre do të trajtohet në pajtim me ligjet në fuqi, sidomos në përputhje me dispozitat e lartpërmendura të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore, si dhe Ligjit mbi Sigurimet Pensionale dhe Invalidore në Kosovë, dhe rrjedhimisht do të njiheshin si të tilla (shih *mutatis mutandis* Pressos Compania Naviera S.A. dhe tjerët kundër Belgjikës, aktgjykimi i 20 nëntorit 1995, Series A nr. 332, para. 31; S.A. Dangeville kundër Francës, Nr. 36677/97, para. 46 48, ECHR 2002-III).

63. Megjithatë, anulimi i njëanshëm i Marrëveshjeve, para përmbushjes së kushtit zgjidhës, kanë shkelur interesat materialë të cilat ishin të njohura sipas ligjit, si dhe të mbrojtura me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (shih EuropePlehanow kundër Polonisë, Parashtresa nr. 22279/04, si dhe Aktgjykimi i 7 korrikut 2009).

64. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese konstaton se ka shkelje të Nenit 46 të Kushtetutës, në përputhje me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

ii. Sa i përket të drejtës për gjykim të drejtë

65. Parashtruesit ankohen më tutje se nuk kanë qenë në gjendje të zhdëmtohen për shkeljen e të drejtave të tyre pronësore në gjykatat e rregullta.

Neni 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] i Kushtetutës thotë si në vijim:

> *1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

> *"Në përcaktimin e të drejtave civile dhe obligimeve ... secili ka të drejtë për dëgjim ... të drejtë ... nga një gjykatë ..."*

66. Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës të veprojë si gjykatë apeli, apo gjykatë e instancës së katërt, në kuptimin e vendimeve të dhëna nga gjykatat e rregullta, duke përfshirë Gjykatën Supreme. Në përgjithësi, "Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit" (Neni 102 i Kushtetutës). Më saktësisht, roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat gjegjëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [ECHR] 1999-I).

67. Në anën tjetër, "Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën" (Neni 112. 1 i Kushtetutës). Kështu, Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë vetëm nëse provat janë prezantuar në mënyrë të duhur, si dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në atë mënyrë që Parashtruesi të ketë gjykim të drejtë (shih, mes burimeve tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Parashtresa Nr. 13071/87 miratuar më 10 korrik 1991).

68. Në bazë të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e njeriut, Neni 6 para. 1 i KEDNJ-së obligon gjykatat që të japin arsyetime për aktgjykimet e tyre, por nuk mund të kuptohet kjo si kërkesë për përgjigje të detajuar për secilin argument. Masa në të cilën kjo detyrë e ofrimit të arsyetimeve mund të dallojë varësisht nga natyra e vendimit. Për më tepër, është e domosdoshme të merret parasysh, *inter alia*, larmia e parashtresave që një palë mund të dorëzojë në gjykata, si dhe dallimet që ekzistojnë në Shtetet Kontraktuese në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, mendimet juridike dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjykimeve. Kështu, pyetja nëse gjykata ka dështuar në përmbushjen e obligimit të parashtrimit të arsyeve, që del nga neni 6 i Konventës mund të përcaktohet vetëm në këndvështrimin e rastit të caktuar (shih Ruiz Torija kundër Spanjës, aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, Series A no. 303-A, § 29).

69. Gjykata Kushtetuese rikujton se Konventa nuk garanton si të tillë të drejtën e qasjes në gjykatë me kompetencën e zhvlerësimit apo anashkalimit të një ligji, apo për të dhënë një interpretim zyrtar të një ligji (shih, *mutatis mutandis*, Gorizdra kundër Moldavisë (dec.), nr. 53180/99, 2 korrik 2002; si dhe James dhe tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, aktgjykimi i 21 shkurtit 1986, Series A nr. 98, para. 81). Ajo as nuk garanton ndonjë të drejtë të referimit të një rasti nga një gjykatë vendore tek një autoritet tjetër vendor apo ndërkombëtar për vendim paraprak (shih Cowme dhe tjerët kundër Belgjikës, nr. 32492/96, 32547/96, 32548/96, 33209/96 dhe 33210/96, para. 114, GJEDNJ 2000-VII). Kështu, pyetja nëse gjykata ka dështuar të ofrojë arsyetimin e duhur për aktgjykimin e saj apo jo, mund të gjejë përgjigje vetëm në dritën e rrethanave të rastit, siç është thënë më lart.

70. Në rastin në fjalë, Parashtruesit kanë kërkuar nga gjykatat e rregullta të përcaktojnë mosmarrëveshjen e tyre pronësore me KEK-un. Parashtruesit iu kanë referuar shprehimisht dispozitës së Nenit 3 të Marrëveshjeve, duke theksuar se Ligji për Pensionet që themelon Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor nuk është miratuar ende. Ky fakt është vërtetuar nga përfaqësuesit kompetent të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (shih më lartë paragrafin 58).

71. Megjithatë, Gjykata Supreme nuk ka ndërmarrë asnjë përpjekje për analizuar paditë e parashtrueseve nga ky këndvështrim përkundër referencës së theksuar para çdo instance tjetër gjyqësore. Në vend të kësaj, pikëpamja e Gjykatës Supreme ka qenë se është fakt i pamohueshëm që pala e pandehur (KEK) ka përmbushur obligimet e saja ndaj paditësit, që ka qenë pagesa e kompensimit të pagave sipas afatit të përcaktuar deri në themelimin dhe funksionalizimin e Fondit Pensional Invalidor të Kosovës, në fuqi nga 01 janar 2004 (shih më lartë paragrafin 26).

72. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të vendosë se çfarë do të ishte mënyra më e mirë që gjykatat e rregullta të trajtojnë argumentet e Parashtrueseve, d.m.th., përmbushjen e kushtit shfuqizues të Nenit 3 të Marrëveshjeve, përmbushje që përcaktohet po ashtu me Nenin 74(3) të Ligjit për Marrëdhënie Detyrimore marrë parasysh së bashku me Nenin 18 të Ligjit mbi Sigurimin Pensional Invalidor të vitit 1983.

73. Megjithatë sipas mendimit të kësaj Gjykate, Gjykata Supreme duke neglizhuar vlerësimin e kësaj pike në tërësi, edhe pse ka qenë konkrete, e lidhur me çështjen dhe e rëndësishme, ka dështuar në obligimin e saj sipas paragrafit 1 të Nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih *mutatis mutandis,* Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut të 18 korrik 2006, në rastin e Pronina kundër Ukrainës, Kërkesa Nr. 63566/00.)

74. Sipas thënieve të lartcekura, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se ka pasur shkelje të Nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me Nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të Nenit 113 të Kushtetutës, Nenit 20 të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese dhe Neneve 55 dhe 70 të Rregullores së Punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOS

I. *Për të shpallur si të*

a)Të Papranueshme -Kërkesën në lidhje me Parashtruesit në vijim:

1. Imer Ibrahimi,
2. Behram Rrahmani,
3. Halit Bilalli,
4. Shefki Veseli,
5. Ramadan Zeqiri,
6. Nazif Grajqevci,
7. Fatime Hyseni,
8. Adem Berisha,
9. Fetah Latifi,
10. Ragip Megjuani,
11. Ali Latifi, and
12. Shaban Kodraliu.

b) *Pjesërisht të pranueshme- Kërkesën në lidhje me Parashtruesit në vijim:*

13. Sahit Zekolli,
14.Ilaz Ademi,
15.Ali Shala,
16.Shefqet Feta, dhe
17.Selatin Hashani.

c) *Të pranueshme* - Kërkesën në lidhje me Parashtruesit të listuar nën numrat 18-49.

II. Për të gjetur se

a) ka pasur shkelje të Nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në ndërlidhje me Nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastet e Parashtruesve:

13.Sahit Zekolli,
14. Ilaz Ademi,
15. Ali Shala,
16. Shefqet Feta,
17. Selatin Hashani,
18. Jetullah Grajqevci,
19. Avdi Grajqevci,
20. Avdyl Krasniqi,
21. Milazim Shala,
22. Musli Podvorica,
23. Fikrete Hashani,
24. Ferat Berisha,
25. Ahmet Krasniqi,
26. Halit Mjeku,
27. Ali Baruti,
28. Ibush Hashani,
29. Avdyl Luta,
30. Hevzi Demolli,
31. Hajzer Zeqiri,
32. Hilmi Mehmeti,
33. Mustaf Sahiti,
34. Bedri Salihu,
35. Igballe Sallova,
36. Bajram Krasniqi,
37. Murat Rafuna,
38. Fadil Saraqi,
39. Rrahman Merlaku,
40. Zarife Shatrolli,
41. Sami Klinaku,
42. Ismet Grajqevci,

43. Sanije Hashani,
44. Nazmi Raqi,
45. Vehbi Aliu,
46. Selman Berisha,
47. Shefqet Muli,
48. Bajram Syla, dhe
49. Avdullah Selimi;

b) ***ka pasur shkelje të Nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje ne Nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*** *në lidhje me Parashtruesit e njëjtë që kanë pësuar shkelje të Nenit 46 të Kushtetutës siç është theksuar nën IV.*

III. *Për të shpallur si të pavlefshme aktgjykimet e Gjykatës Supreme në rastet e mëposhtme:*

13. Sahit Zekolli, Rev.nr. 90/2008, i datës 25.02.09
14. Ilaz Ademi, Rev. nr.. 229/2008 i datës 10.02.09;
15. Ali Shala, Rev. nr.. 54/2009 i datës 11.02.09;
16. Shefqet Feta, Rev. nr.487/2008 i datës 11.02.09;
17. Selatin Hashani, Rev. nr. 59/09 i datës 30.06.08;
18. Jetullah Grajqevci, Rev. nr.150/2009 i datës 02.06.09;
19. Avdi Grajqevci, Rev. nr. 227/2008 i datës 11.02.09;
20. Avdyl Krasniqi, Rev. nr. 476/2008 i datës 23.02.09;
21. Milazim Shala, Rev. nr. 574/2008 i datës 11.02.09;
22. Musli Podvorica, Rev. nr. 464/2008 i datës 23.02.09;
23. Fikrete Hashani, Rev. nr. 225/2009 i datës 18.06.09;
24. Ferat Berisha, Rev. nr. 138/2009 i datës 02.06.09;
25. Ahmet Krasniqi, Rev. nr.426/2008 i datës 10.02.09
26. Halit Mjeku, Rev. nr.567/08 i datës 10.03.09;
27. Ali Baruti, Rev. nr. 45/2009 i datës 11.02.09,
28. Ibush Hashani, Rev. nr.97/2009 i datës 17.03.09;
29. Avdyl Luta, Rev. nr.565/2008 i datës 11.02.09;
30. Hevzi Demolli, Rev. nr.64/2009 i datës 02.02.09;
31. Hajzer Zeqiri Rev. nr. 518/2008 i datës 23.02.09;
32. Hilmi Mehmeti, Rev. nr. 571/2008 i datës 11.02.09;
33. Mustaf Sahiti, Rev. nr. 259/2008 i datës 23.02.09;
34. Bedri Salihu, Rev. nr.435/2008 i datës 10.02.09;
35. Igballe Sallova, Rev. nr.545/2008 i datës 23.02.09;
36. Bajram Krasniqi, Rev. nr.569/2008 i datës 23.02.09;
37. Murat Rafuna, Rev. nr.491/2008 i datës 23.02.09;
38. Fadil Saraqi, Rev. nr.506/2008 i datës 23.02.09;
39. Rrahman Merlaku, Rev. nr.441/2008 i datës 10.02.09;
40. Zarife Shatrolli, Rev. nr. 454/2008 i datës 23.02.09;
41. Sami Klinaku, Rev. nr.63/2009 i datës 11.02.09;
42. Ismet Grajqevci, Rev. nr.479/2008 i datës 23.02.09;
43. Sanije Hashani, Rev. nr. 460/2008 i datës 11.02.09;
44. Nazmi Raqi, Rev. nr.270/2009 i datës 18.06.09;
45. Vehbi Aliu, Rev. nr.269/2009 i datës 01.07.09;
46. Selman Berisha, Rev. nr. 41/09 i datës 30.06.09;
47. Shefqet Muli, Rev. nr. 222/2008 i datës 10.02.09;
48. Bajram Syla, Rev. nr. 142/2009 i datës 17.03.09;
49. Avdullah Selimi, Rev. nr. 438/2008 i datës 10.02.09.

IV. Këto aktgjykime rikthehen në Gjykatën Supreme për rishqyrtim në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

V. Mbetet seriozisht e përkushtuar në zgjidhjen e rastit, në pritje të zbatimit të këtij Aktgjykimi.

Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë në ditën e dorëzimit të tij tek palët.

Prishtinë, në këtë ditë të 23 qershorit të vitit 2010.

Gjyqtari raportues

Kadri Kryeziu

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA KUSHTETUESE PRISHTINË
USTAVNI SUD-PRIŠTINA
REPUBLIKA KOSOVO

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani